

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik

Titulli i Projektaktit : Mbledhja e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me “Për miratimin e Planit të masave për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026” bashkinë Durrës

Grupet që u konsultuan: Banorët e Bashkisë Durrës.

Total i pjesëmarrësve në konsultime : Konsultimi publik u zhvillua me procedure publikimi online të njoftimit dhe njëkohësisht të vendosjes së materialeve online në faqen web <https://durrës.gov.al/category/bashkia/njoftime/> dhe <https://durrës.gov.al/konsultimet-publike/>

Numri i pjesëmarrësve: 16 Pjesëmarrës në total, nga të cilët, 7 janë burra dhe 9 gra.

Numri i personave që dhanë rekomandime: 2

Nga procesverbali i takimit : Po

Të dërguara me postë : Jo

Rekomandimet paraqiten si më poshtë:

1. Të hapen rrugë për zjarrëfikëse që s'ekzistojnë dhe të shkojnë në çdo cep të malit. Rrugë që të futet vetëm zjarrëfikësja dhe kjo mund të bëhet me një minieskavator dhe me pak buxhet dhe të merret leja.

2. Në planin afatmesëm, mund të bëhen depozita me ujë që zjarrëfikësja të mbushet në mal, kur ka burime uji dhe nuk është kosto e lartë as kjo. Këto janë plane që mund të bëhen afatgjata dhe ti e parandalon këtë gjë.
3. Tre paga rojtarë me 500.000 ALL minimumi (të vjetra) dhe e vendos dhe mban përgjegjësi ai për zjarret për parandalimin kur shikon një tym.
4. Sensibilizimi për ligjin që kur digjen mbeturinat drusore, se këtu ka ullinj ato degët që priten, kur është koha për t'u djegur dhe pas asaj kohe nuk lejohet për t'u djegur.
5. Marrëveshje me universitetin për studentët për të ndihmuar vullnetarisht të përgjegjshëm, grupe vullnetare, studentë, dhe studentët që caktohen, që jetojnë në ato zona dhe ato pastaj përfitojnë ndonjë kredit plus në shkollë. Pra, jo ana monetare, por që të jenë të përgjegjshëm. Pra të njoftojnë për rënien e zjarrit në zonat ku jetojnë.

Këto rekomandime ju dërguan Drejtorisë që ka përgatitur materialin dhe këshilltarëve.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

D. Murataj

Sekretariati i Këshillit Bashkiak

D.Milja